



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

---

**PROJEKTLIGJI PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS<sup>1</sup>**

**DRAFT LAW ON FOREIGN SERVICE OF THE REPUBLIC OF KOSOVO<sup>2</sup>**

**NACRT ZAKON O STRANOJ SLUŽBI REPUBLIKE KOSOVO<sup>3</sup>**

---

<sup>1</sup> Projektligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 47 – të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendim Nr.01/47 me datë 02.09.2015.

<sup>2</sup>Draft Law on Foreign Service of the Republic of Kosovo, was approved in the 47-meeting of the Government of Republic of Kosova with the decision No. 01/47 dt. 02.09.2015.

<sup>3</sup>Nacrt Zakon o Stranoj Službi Republike Kosovo, , usvojenje na 47-oj sednici Vlade Republike Kosova, odlukom Br.01/47 od 02.09.2015.

<p><b>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</b></p> <p>Në pajtim me nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës</p> <p>Miraton:</p> <p><b>LIGJ PËR SHËRBIMIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b></p> <p><b>KAPITULLI I</b> <b>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 1</b> <b>Qëllimi</b></p> <p>Qëllimi i ligjit është rregullimi i veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, përfshirë këtu Ministrinë e Punëve të Jashtme si dhe përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 2</b> <b>Fushëveprimi</b></p> <p>1. Ky Ligj rregullon funksionimin e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili përfshinë Ministrinë e Punëve të Jashtme, misionet diplomatike, postet konsullore dhe nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, si dhe çështjet tjera që ndërlidhen me funksionimin dhe veprimtarinë e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës.</p>	<p><b>Assembly of the Republic of Kosovo,</b></p> <p>In accordance with Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo</p> <p>Approves:</p> <p><b>LAW ON FOREIGN SERVICE OF THE REPUBLIC OF KOSOVO</b></p> <p><b>CHAPTER I</b> <b>GENERAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 1</b> <b>Purpose</b></p> <p>The purpose of law is to regulate the activities of the Foreign Service of the Republic of Kosovo, including the Ministry of Foreign Affairs and diplomatic and consular representations of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 2</b> <b>Scope</b></p> <p>1. This Law regulates the functioning of the Foreign Service of the Republic of Kosovo, which includes the Ministry of Foreign Affairs, diplomatic missions, consular posts and employees of the Foreign Service of the Republic of Kosovo, and other issues related to the functioning and activities of the Foreign Service of the Republic of Kosovo.</p>	<p><b>Skupština Republika Kosovo,</b></p> <p>U skladu sa članom 65. (1) Ustava Republike Kosovo</p> <p>Usvaja:</p> <p><b>ZAKON O STRANOJ SLUŽBI REPUBLIKE KOSOVO</b></p> <p><b>POGLAVLJE I</b> <b>OPŠTE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 1</b> <b>Svrha</b></p> <p>Svrh zakona je da se regulira pravna osnova Inostrane Službe Republike Kosova, uključujući i Ministarstvo Inostranih Poslova i diplomatsko-konzularna predstavništava Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 2</b> <b>Djelovanje</b></p> <p>1. Ovaj zakonom uređuje funkcioniranje Inostrane Službe Republike Kosova, koja uključuje Ministarstvo Inostranih Poslova, diplomatske misije, konzularna predstavništva i službenike Inostrane Službe Republike Kosova i druga pitanja vezana za funkcioniranje i aktivnosti Inostranih Službi Republike Kosovo.</p>
---	---	---

<p>2. Me këtë ligj rregullohen veçanërisht:</p> <p>2.1 Funksionet dhe mënyra e organizimit të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës;</p> <p>2.2 Funksionimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke përfshirë edhe misionet diplomatike dhe postet konsullore;</p> <p>2.3 Kriteret dhe procedurat e pranimit në Shërbimin e Jashtëm;</p> <p>2.4 Procedurat e emërimit të Kreut të misionit diplomatik, postit konsullor dhe personelit të tyre;</p> <p>2.5 Statusi i diplomatit dhe sistemi i karrierës diplomatike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 3 Përkufizimet</b></p> <p>1. Për qëllim të këtij ligji, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme, kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1 “<i>Kuvendi</i>” - nënkupton Kuvendin e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2 “<i>Komisioni parlamentar</i>” – nënkupton Komisionin për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës;</p>	<p>2. This law regulates especially:</p> <p>2.1 The functions and the method of organization of the Foreign Service of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.2 The functioning of the Ministry of Foreign Affairs, including diplomatic missions and consular posts;</p> <p>2.3 The criteria and procedures of admission to the Foreign Service;</p> <p>2.4 The procedures of appointment of the head of the diplomatic mission, consular post and its personnel;</p> <p>2.5 The status of diplomat and the diplomatic career system.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 3 Definitions</b></p> <p>1. For the purpose of this law, the following words and expressions shall have the following meanings;</p> <p>1.1 “<i>Assembly</i>” – means the Assembly of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2 “<i>Parliamentary Commission</i>” – means the Foreign Affairs Commission of the of the Kosovo Assembly;</p>	<p>2. Ovaj zakon uređuje naročito</p> <p>2.1 funkcije i način organizovanja Inostrane Službe Republike Kosovo;</p> <p>2.2 funkcioniranje Ministarstva Inostranih Poslova, uključujući i diplomatske misije i konzularna predstavništva;</p> <p>2.3 kriteriji i procedure za prihvaćanje Inostrane Službe;</p> <p>2.4 procedure za imenovanje šefa diplomatske misije, konzularnog predstavnika i njihova osoblja;</p> <p>2.5 status diplomata i sistem diplomatske kariere.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 3 Definicije</b></p> <p>1. Za potrebe ovog zakona, sljedeće riječi i izrazi imaju sljedeća značenja:</p> <p>1.1 “<i>Skupština</i>” - znači Skupština Republike Kosova;</p> <p>1.2 “<i>Parlamentarna komisija</i>”- znači Komisija za Inostrane Poslove Vlade Kosova;</p>
--	--	---

<p>1.3 “<i>Presidenti</i>” - nënkupton presidentin e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.4 “<i>Ministria</i>” - nënkupton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.5 “<i>Ministri</i>”- është ministri i Punëve të Jashtme të Qeverisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>1.6 “<i>Shtetas i Republikës së Kosovës</i>” - është personi fizik i cili mban shtetësinë e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.7 “<i>Mision diplomatik</i>” - është Ambasada, Misioni i Përhershëm në organizata ndërkombëtare, ose zyra tjetër, e cila përfaqëson Republikën e Kosovës në shtete të tjera, ose në organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare, e ngritur sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (1961);</p> <p>1.8 “<i>Post konsullor</i>”- është Konsullata e Përgjithshme, Konsullata, Nënkonsullata dhe Zyra Konsullore, e ngritur sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore (1963);</p> <p>1.9 “<i>Përfaqësuesi diplomatik</i>”- është shefi i misionit ose një anëtar i personelit diplomatik të misionit;</p> <p>1.10 <i>Gradat Diplomatike dhe Konsullore</i>”- janë titujt e dhënë ose të fituar</p>	<p>1.3 “<i>President</i>” – means the President of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4 “<i>Ministry</i>” – means the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5 “<i>Minister</i>” – is the Minister of Foreign Affairs of the Government of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.6 “<i>Citizen of the Republic of Kosovo</i>” – is a physical person who holds citizenship of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.7 “<i>Diplomatic mission</i>” – is the Embassy, Permanent Mission at international organizations, or other office, which represents the Republic of Kosovo at other countries, or at intergovernmental international organization, established in accordance to the Vienna Convention on Diplomatic Relations (1961);</p> <p>1.8 “<i>Consular post</i>” – is the Consulate General, Consulate, Vice Consulate and Consulate Office, established in accordance to the Vienna Convention on Consular Relations (1963);</p> <p>1.9 “<i>Diplomatic representative</i>” – is the head of mission or a member of the diplomatic personnel of the mission;</p> <p>1.10 “<i>Diplomatic and Consular Ranks</i>” – are the ranks awarded or obtained of the</p>	<p>1.3 “<i>Predsednik</i>” - znači Predsednik Republike Kosovo;</p> <p>1.4 “<i>Ministarstvo</i>” – znači Ministarstvo Inostranih Poslova Republike Kosovo;</p> <p>1.5 “<i>Ministar</i>” - je Ministar Inostranih Poslova Republike Kosovo;</p> <p>1.6 “<i>Državljanin Republike Kosovo</i>” - je osoba koja ima državljanstvo Republike Kosova;</p> <p>1.7 “<i>Diplomatska Misija</i>”-je Ambasada, Stalna misija međunarodnih organizacija, ili druga kancelarija, koja predstavlja Republiku Kosovo u drugim državama ili međuvladinim međunarodnim organizacijama, osnovana prema Bečkoj Konvenciji o Diplomatskim Odnosima (1961);</p> <p>1.8 “<i>Konzularno Predstavništvo</i>” - je Generalni Konzulat, Konzulat, Potpredsjednik Konzula i Konzularna Kancelarija, osnovana prema Bečkoj Konvenciji o konzularnim odnosima(1963);</p> <p>1.9 “<i>Diplomatski predstavnik</i>” - je šef misije ili član diplomatskog osoblja misije;</p> <p>1.10 “<i>Diplomatske i Konzularni Činovi</i>”- date po naslovu ili steknu se kao</p>
---	--	---

<p>të përfaqësuesve diplomatikë dhe konsujve, të renditur sipas përparësisë ose epërsisë hierarkike;</p> <p>1.11 <i>“Nëpunës i Shërbimit të Jashtëm”</i> - është diplomati i karrierës, Kreu i misionit diplomatik i emëruar jashtë sistemit të karrierës diplomatike, si dhe shërbyesit civil të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme;</p> <p>1.12 <i>“Kreu i Misioni Diplomatik”</i> - është ambasadori ose personi i autorizuar nga institucionet kompetente të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.13 <i>“Diplomat i karrierës”</i> – është pjesëtari i Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili është rekrutuar në procedurë të konkursit dhe i cili kalon nëpër procesin e gradimit sipas këtij ligji.</p>	<p>diplomatic representatives and consuls, in order of priority or hierarchy superiority;</p> <p>1.11 <i>“Employee of the Foreign Service”</i> – is a career diplomat, head of the diplomatic mission appointed beyond diplomatic career system, and civil servants employed at the Ministry of Foreign Affairs;</p> <p>1.12 <i>“Head of the Diplomatic Mission”</i> – is the ambassador or the person authorized by the competent institutions of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.13 <i>“Career Diplomat”</i> – is a member of the Foreign Service of the Republic of Kosovo, that was recruited upon vacancy announcement procedure and who passes through the promotion process in accordance to this law.</p>	<p>diplomatski predstavnik i konzul, poređani po prioritetima ili hijerarhije superiornosti;</p> <p>1.11 <i>“Službenik Inostranih Službi”</i> - je diplomata u karteri, šef diplomatske misije imenovan izvan diplomatske karijere i kao državni službenik zaposlen u Ministarstvu Inostranih Poslova;</p> <p>1.12 <i>“Šef diplomatske misije”</i> - je ambasador ili ovlašćeno lice od strane nadležnih institucija Republike Kosovo;</p> <p>1.13 <i>“Diplomata u karijeri”</i> - je član Diplomatske Službe Republike Kosovo, koji je regrutiran u postupku konkurencije i koji prolazi kroz procese ocenjivanja u skladu sa zakonom.</p>
<p><b>KAPITULLI II</b> <b>ORGANIZIMI I SHERBIMIT I JASHTEM</b></p> <p><b>Neni 4</b> <b>Shërbimi i Jashtëm</b></p> <p>1. Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Kosovës përbëhet nga Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe nga misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Kosovës.</p>	<p><b>CHAPTER II</b> <b>ORGANIZATION OF THE FOREIGN SERVICE</b></p> <p><b>Article 4</b> <b>Foreign Service</b></p> <p>1. Foreign Service of the Republic of Kosovo consists of the Ministry of Foreign Affairs, as well as of diplomatic missions and consular posts of the Republic of Kosovo.</p>	<p><b>POGLAVLJE II</b> <b>ORGANIZACIJA INOSTRANE SLUŽBE</b></p> <p><b>Član 4</b> <b>Inostrane Službe</b></p> <p>1. Inostrane Službe Republike Kosova, uključujući i Ministarstvo Inostranih Poslova, kao i diplomatskim misijama i konzularnim predstavništvima Republike Kosovo.</p>

<p>2. Shërbimi i Jashtëm i Republikës së Kosovës është në funksion të politikës së jashtme të vendit që udhëhiqet nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhe e cila propozohet dhe zbatohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.</p>	<p>2. Foreign Service of the Republic of Kosovo is in function of the country's foreign policy led by the President of the Republic of Kosovo and which is proposed and implemented by the Government of the Republic of Kosovo.</p>	<p>2. Inostrana služba Republike Kosovo je u funkciji vanjske politike zemlje na čelu sa Predsednikom Republike Kosovo i koja se predlaže i sprovodi od Vlade Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 5</b> <b>Funksionet e Shërbimit të Jashtëm</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 5</b> <b>Foreign Service Functions</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 5</b> <b>Funksije Inostrane Službe</b></p>
<p>1. Shërbimi i Jashtëm realizon politikën e jashtme të Republikës së Kosovës në raport me shtetet e tjera, organizatat ndërkombëtare, si dhe subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, në bazë të Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare në të cilat Republika e Kosovës është palë, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në pajtim me strategjinë dhe prioritetet e politikës së jashtme të përcaktuara nga Presidenti dhe Qeveria.</p>	<p>1. Foreign Service realizes foreign policy of the Republic of Kosovo in relation to other countries, international organizations and other subjects of international law, based on the Constitution, international treaties to which the Republic of Kosovo is a party, as well as laws and regulations in force, and in accordance to the strategy and foreign policy priorities determined by the President and the Government.</p>	<p>1. Inostrana Služba provodi vanjsku politiku Republike Kosovo u odnosu sa drugim državama, međunarodne organizacije, kao i drugih subjekata međunarodnog prava, u skladu sa Ustavom, međunarodnim ugovorima kojima Republika Kosovo je stranka, i akta i propisima koji su na snazi kao i u skladu sa strategiom i prioritetima inostrane politike definisana od Predsednika i Vlade.</p>
<p>2. Shërbimi i Jashtëm ka për detyrë që të:</p> <p>2.1. Shpreh dhe mbron interesat shtetërore të Republikës së Kosovës në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare;</p> <p>2.2. Nxit forcimin e marrëdhënieve miqësore të Republikës së Kosovës me shtetet e tjera, organizatat ndërkombëtare, si dhe subjekte të tjera të së drejtës ndërkombëtare;</p> <p>2.3. Zhvillon marrëdhënie politike, ekonomike, sociale dhe kulturore me vende</p>	<p>2. Foreign Service has a duty to:</p> <p>2.1. Express and protect state interests of the Republic of Kosovo in the field of international relations;</p> <p>2.2. Promote strengthening of friendly relations of the Republic of Kosovo with other countries, international organizations and other subjects of international law;</p> <p>2.3. Develop political, economic, social and cultural relations with other countries;</p>	<p>2. Inostrana Služba ima dužnost da:</p> <p>2.1. Izražavaju i štite državne interese Republike Kosovo u oblasti međunarodnih odnosa</p> <p>2.2. Podstiče jačanje prijateljskih odnosa Republike Kosovo sa drugim zemljama, međunarodnim organizacijama i drugim subjektima međunarodnog prava;</p> <p>2.3. Razvija političkih, ekonomskih, socijalnih i kulturnih odnos sa drugim</p>

<p>të tjera;</p> <p>2.4. Mbron të drejtat dhe interesat e shtetasve të Republikës së Kosovës, si dhe të drejtat dhe interesat e shtetasve kosovar dhe qytetarëve me prejardhje nga Kosova që jetojnë jashtë kufijve të Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;</p> <p>2.5. Bashkërendon veprimtarinë me jashtë të institucioneve qendrore dhe vendore;</p> <p>2.6. Nxit dhe realizon plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Kosovës është palë.</p>	<p>2.4. Protect the rights and interests of citizens of the Republic of Kosovo, and the rights and interests of Kosovo citizens, and citizens originally from Kosovo living outside the borders of the Republic of Kosovo, in accordance with the Constitution and applicable legislation;</p> <p>2.5. Coordinate foreign activities of central and local institutions;</p> <p>2.6. Promote and realizes the fulfillment of obligations arising from the international treaties, to which the Republic of Kosovo is a party.</p>	<p>zemljama;</p> <p>2.4. Štiti prava i interese građana Republike Kosovo i prava i interesa građana Kosova i građana Kosovskog porekla koji žive izvan granica Republike Kosovo, u skladu sa Ustavom i zakonima koji su na snazi;</p> <p>2.5. Kordinira deladnost sa centralnim i lokalnim institucijama;</p> <p>2.6. Promovira i provodi ispunjavanje obaveza koje proizilaze iz međunarodnih akta, u kojima Republika Kosovo je stranka.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 6</b> <b>Ministria e Punëve të Jashtme</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 6</b> <b>Ministry of Foreign Affairs</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 6</b> <b>Ministarstvo Inostranih Poslova</b></p>
<p>1. Ministria e Punëve të Jashtme, si organ i Qeverisë së Republikës së Kosovës, propozon dhe zbaton politikën e jashtme të Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, aktet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Kosovës është palë, si dhe në pajtim me interesin shtetëror të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Ministria e Punëve të Jashtme në veçanti:</p> <p>2.1. Bashkërendon qëndrimet zyrtare të politikës së jashtme me institucionin e Presidentit, Kuvendin, Qeverinë, dhe institucionet e tjera shtetërore për çështje të</p>	<p>1. The Ministry of Foreign Affairs, as the body of the Government of the Republic of Kosovo, proposes and implements the foreign policy of the Republic of Kosovo, in accordance to the Constitution of the Republic of Kosovo, international treaties, to which the Republic of Kosovo is a party, and in accordance to the national interests of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Ministry of Foreign Affairs, in particular:</p> <p>2.1. Coordinates official positions of foreign policy with the institution of the President, Assembly, Government, and</p>	<p>1. Ministarstvo Inostranih Poslova predlaže i provodi vanjsku politiku Republike Kosovo, u skladu sa Ustavom Republike Kosovo, međunarodnim ugovora u kojima je Republika Kosovo je članica, a u skladu s nacionalnim interesima Republike Kosovo.</p> <p>2. Ministarstvo Inostranih Poslova u posebnosti:</p> <p>2.1. Koordinira službeni položaj vanjske politike sa institucijom Predsednika,</p>

<p>politikës së jashtme të Republikës së Kosovës;</p> <p>2.2. Komunikon me misionet diplomatike dhe postet konsullore të shteteve të tjera, si dhe misionet e organizatave ndërkombëtare e subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, të akredituara në Republikën e Kosovës në përputhje me praktikën diplomatike;</p> <p>2.3. Drejton dhe bashkërendon veprimtarinë e misioneve diplomatike, misioneve të përhershme, posteve konsullore, misioneve të përbashkëta dhe misioneve të posaçme të Republikës së Kosovës;</p> <p>2.4. Mbikëqyr, bashkërendon dhe përcjellë procedurat për lidhjen e akteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare;</p> <p>2.5. Depoziton marrëveshjet origjinale ndërkombëtare të lidhura në emër të qeverisë dhe të Republikës së Kosovës;</p> <p>2.6. Përpunon, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin e veprimtarisë së Shërbimit të Jashtëm;</p> <p>2.7. Administron me pronat dhe pasuritë e Ministrisë dhe Shërbimit Diplomatik, në</p>	<p>other state institutions on issues of foreign policy of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.2. Communicates with diplomatic missions and consular posts of other countries, as well as missions of international organizations and other subjects of international law, accredited in the Republic of Kosovo, in accordance to the diplomatic practice;</p> <p>2.3. Directs and coordinates the activity of diplomatic missions, permanent missions, consular posts, joint missions and special missions of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.4. Supervises, coordinates and follows the procedures on concluding international treaties and agreements, as well as membership of the Republic of Kosovo to the international organizations;</p> <p>2.5. Deposits original international agreements concluded on behalf of the government and of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.6. Process, store and archive all the documentation of the Foreign Service activity;</p> <p>2.7. Administers the properties and assets of the Ministry and Diplomatic Service in</p>	<p>Parlament, Vlade, i druge državne institucije o pitanjima vanjske politike Republike Kosovo;</p> <p>2.2. Komunicira sa diplomatskim i konzularnim misijama drugih država i misijama međunarodnih organizacija i drugim subjektima međunarodnog prava, akreditirani u Republici Kosovo, u skladu sa diplomatskom praksom;</p> <p>2.3. Usmerava i usklađuje aktivnosti diplomatskih misija, stalne misije, konzularna predstavništva, zajedničke misije i specijalne misije Republike Kosovo;</p> <p>2.4. Nadgleda, koordinira i prati postupke za povezivanje akata i međunarodnim sporazumima, kao i članstvo Republike Kosova u međunarodnim organizacijama;</p> <p>2.5. Deponuje originalne međunarodne sporazume u ime Vlade Republike Kosovo;</p> <p>2.6. Prerađuje, čuva i arhivira svu dokumentaciju i aktivnosti Inostrane Službe.</p> <p>2.7. Administrira imovinom i sredstvima Ministarstva i Diplomatske Službe u skladu</p>
--	---	--



<p>përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës;</p> <p>2.8. Kryen punë dhe ushtron veprimtari të tjera të përcaktuara me ligj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 7</b> <b>Ministri i Punëve të Jashtme</b></p> <p>1. Ministri i Punëve të Jashtme siguron zbatimin e programit të qeverisë për politikën e jashtme, si dhe propozon dhe zbaton objektivat e politikës së jashtme në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.</p> <p>2. Ministri i Punëve të Jashtme drejton dhe përfaqëson shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Ministri i Punëve të Jashtme ushtron detyra dhe përgjegjësi të tjera, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.</p>	<p>accordance to the applicable laws in the Republic of Kosovo;</p> <p>2.8. Perform tasks and carries out other activities determined by the law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 7</b> <b>Minister of Foreign Affairs</b></p> <p>1. Minister of Foreign Affairs ensures the implementation of the government program for foreign policy, and proposes and implements foreign policy objectives in accordance to the Constitution and applicable laws.</p> <p>2. Minister of Foreign Affairs leads and represents the foreign service of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Minister of Foreign Affairs carries out other duties and responsibilities, in accordance to the Constitution and applicable laws.</p>	<p>sa zakonima koji su u snazi u Republici Kosovo.</p> <p>2.8. Vršiti i obavlja i druge poslove propisane zakonom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 7</b> <b>Ministar Inostranih Poslova</b></p> <p>1. Ministarstvo Inostranih Poslova osigurava primjenu vanjske politike Vlade, a predlaže i sprovodi ciljeva vanjske politike u skladu s Ustavom i zakonima.</p> <p>2. Ministar Inostranih Poslova vodi i predstavlja inostrane službe Republike Kosovo.</p> <p>3. Ministar Inostranih Poslova obavlja i druge dužnosti i odgovornosti u skladu sa Ustavom i zakonima na snazi.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 8</b> <b>Kompetenca për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare</b></p> <p>1. Ministri i Punëve të Jashtme, Presidenti dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, kanë fuqinë dhe kompetencën për të nënshkruar traktate dhe marrëveshje të tjera të detyrueshme ndërkombëtare në emër të Republikës së Kosovës si dhe për të nënshkruar instrumente të anëtarësimit në organizata</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 8</b> <b>Competence on concluding international agreements</b></p> <p>1. Minister of Foreign Affairs, the President and Prime Minister of the Republic of Kosovo, have the power and authority to sign treaties and other internationally binding agreements, on behalf of the Republic of Kosovo, and to sign instruments of membership to international organizations and instruments of</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 8</b> <b>Nadležnost za povezivanje međunarodnih sporazuma</b></p> <p>1. Ministar Inostranih Poslova, Predsednik i Premijer Republike Kosova, imaju moć i autoritet da potpišu ugovore i druge sporazume međunarodno obavezujuće u ime Republike Kosovo, kao i potpisati instrumente o članstvu u međunarodnim organizacijama i instrumentima o pristupanju u međunarodnim</p>

<p>ndërkombëtare dhe instrumente të aderimit në marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe të cilat veç janë në fuqi.</p> <p>2. Procedura për dhënien e autorizimit personave të tjerë për të kryer veprimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni si dhe procedurat për lidhjen dhe ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare përcaktohen me ligj të veçantë.</p>	<p>adherence to the international multilateral agreements which are already in force.</p> <p>2. The procedures for authorizing other persons to perform the actions determined in paragraph 1 of this Article, and the procedures on conclusion and ratification of international agreements are determined by special law.</p>	<p>multilateralnim sporazumima koji su već na snazi.</p> <p>2. Procedure za odobravanje ovlašćenja drugim osobama za obavljanje aktivnosti iz stava 1 ovog člana i procedure za povezivanje i ratifikaciju međunarodnih sporazuma određenim sa posebnim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 9</b> <b>Zëvendësministri i Punëve të Jashtme</b></p> <p>1. Zëvendësministri i Punëve të Jashtme ka për detyrë t'i sigurojë Ministrin të Punëve të Jashtme bashkëpunim për çështje të caktuara të politikës së jashtme, sipas detyrave të cilat ia cakton Ministri i Punëve të Jashtme.</p> <p>2. Zëvendësministri i Punëve të Jashtme, në mungesë të Ministrin të Punëve të Jashtme, drejton dhe përfaqëson Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 9</b> <b>Deputy Minister of Foreign Affairs</b></p> <p>1. The duty of the Deputy Minister of Foreign Affairs is to provide cooperation to the Minister of Foreign Affairs on certain issues of foreign policy, according to the tasks assigned by the Minister of Foreign Affairs.</p> <p>2. Deputy Minister of Foreign Affairs, in the absence of Minister of Foreign Affairs, governs and represents the Foreign Service of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 9</b> <b>Zamenik Ministra Inostranih Poslova</b></p> <p>1. Zamenik ministar Inostranih Poslova dužan je da pruži Ministru Inostranih Poslova saradnju, o određenim pitanjima vanjske politike, pod kojim poslovima mu dodeli Ministar Inostranih Poslova.</p> <p>2. Zamenik ministar Inostranih Poslova, u odsustvu Ministra Inostranih Poslova, upravlja i predstavlja Inostranu Službu Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 10</b> <b>Sekretari i Përgjithshëm</b></p> <p>1. Sekretari i Përgjithshëm përzgjidhet dhe emërohet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për shërbimin civil.</p> <p>2. Sekretari i Përgjithshëm ka kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 10</b> <b>Secretary General</b></p> <p>1. Secretary General is selected and appointed in accordance to the applicable legal provisions of the civil service.</p> <p>2. Secretary General has the competences and responsibilities determined in the Law on State Administration of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 10</b> <b>Generalni Sekretar</b></p> <p>1. Generalni sekretar se bira i imenuje u skladu sa zakonskim odredbama koje se primenjuju u državnoj službi.</p> <p>2. Generalni sekretar ima ovlašćenja i odgovornost utvrđene Zakonom o Državnoj Upravi Republike Kosovo</p>

<p>3. Detyrat dhe përgjegjësitë tjera të Sekretarit të Përgjithshëm përcaktohen me dispozitat ligjore ne fuqi dhe aktet nënligjore të nxjerra bazuar me këtë ligj.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 11 Inspektori Diplomatik</b></p> <p>1. Ministria e Punëve të Jashtme kujdeset dhe siguron që misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Kosovës veprojnë në mënyrë të ligjshme, etike dhe ekonomike dhe që shfrytëzojnë burimet e tyre njerëzore dhe financiare në mënyrë efikase dhe në interes të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Ministri i Punëve të Jashtme emëron një diplomat të karrierës të gradës jo më pak se Ministër Këshilltar që të inspektojë dhe kontrollojë misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Inspektori diplomatik ka kompetencat dhe përgjegjësitë si në vijim:</p> <p>3.1. Inspekton objektet dhe punën e misioneve diplomatike dhe të posteve konsullore të Republikës së Kosovës;</p> <p>3.2. Inspekton dokumentet zyrtare, regjistrat dhe arkivat e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të Republikës së Kosovës;</p> <p>3.3. Zhvillon biseda dhe konsultime me</p>	<p>3. Other duties and responsibilities of the Secretary General shall be determined by the applicable law provisions and sublaw acts adopted based on this law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 11 Diplomatic Inspector</b></p> <p>1. Ministry of Foreign Affairs takes regard and ensures that the diplomatic missions and consular posts of the Republic of Kosovo operate in legal, ethical and economic manner and utilizes its human and financial resources efficiently and in the interest of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Minister of Foreign Affairs appoints a career diplomat of the rank not less than Minister Counselor to inspect and control the diplomatic missions and consular posts of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Diplomatic Inspector has the following competences and responsibilities:</p> <p>3.1. Inspects facilities and the work of diplomatic missions and consular posts of the Republic of Kosovo;</p> <p>3.2. Inspects official documents, registers and archives of the diplomatic missions and consular posts of the Republic of Kosovo;</p> <p>3.3. Conducts discussions and</p>	<p>3. Ostale dužnosti i odgovornosti Generalnog Sekretara utvrđuje se važećim propisima i podzakonskim aktima na osnovu ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 11 Diplomatski Inspektoriat</b></p> <p>1. Ministarstvo Inostranih Poslova stara se i osigurava da se diplomatskim misijama i konzularnim predstavništvima Republike Kosovo posluju legalno, etički i ekonomski i iskoriste svoje ljudske i finansijske resurse efikasno i u interesu Republike Kosovo.</p> <p>2. Ministar Inostranih Poslova imenuje diplomate kariere ne manje od Ministra Savetnika da inspektuje i kontrolira diplomatske i konzularne misije Republike Kosovo</p> <p>3. Diplomatski inspektor ima kompetencije i odgovornosti kako sledi:</p> <p>3.1. Inspektira objekat i rad diplomatskih i konzularnih misija Republike Kosovo;</p> <p>3.2. Inspektira službene dokumente, evidenciju i arhivu diplomatskih i konzularnih misija Republike Kosovo;</p> <p>3.3. Razvija razgovore i konsultacija sa</p>
---	---	---

<p>personelin e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore për nevojat e inspektimit;</p> <p>3.4. Këshillon Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Sekretarin e Përgjithshëm lidhur me ligjshmërinë, efektivitetin dhe efikasitetin e punës së misioneve diplomatike dhe posteve konsullore si dhe etikën profesionale të nëpunësve;</p> <p>3.5. Përpilon dhe ia dorëzon Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Sekretarit të Përgjithshëm çdo vjet kalendarik, dhe jo më vonë se deri me 1 mars të çdo viti, një raport për punën dhe organizimin e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore si dhe mënyrën e shfrytëzimit të burimeve njerëzore dhe financiare të tyre;</p> <p>3.6. Në rast se konstaton shkelje ligjore ose keq menaxhim të burimeve njerëzore ose financiare në një ose më shumë misione diplomatike ose poste konsullore, menjëherë i raporton Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Sekretarit të Përgjithshëm për gjetjet e tij;</p> <p>3.7. I rekomandon Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Sekretarit të Përgjithshëm masat e nevojshme për përmirësimin e organizimit dhe të punës së misioneve diplomatike dhe posteve konsullore.</p> <p>4. Inspektori Diplomatik ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij në mënyrë të pavarur dhe të</p>	<p>consultations with the personnel of diplomatic missions and consular posts about the inspection needs;</p> <p>3.4. Advises the Minister of Foreign Affairs and Secretary General on the legality, effectiveness and efficiency of work of the diplomatic missions and consular posts, as well as professional ethics of employees;</p> <p>3.5. Compiles and submits a report to the Minister of Foreign Affairs and to Secretary General, each calendar year, not later than 1<sup>st</sup> March of each year, about the work and organization of diplomatic missions and consular posts and about the method of utilization of its human and financial resources;</p> <p>3.6. In the event of finding violation or mismanagement of human and financial resources in one or more diplomatic missions or consular posts, immediately reports to the Minister of Foreign Affairs and Secretary General of its findings;</p> <p>3.7. Recommends to the Minister of Foreign Affairs and Secretary General the necessary measures on improving the organization and the work of diplomatic missions and consular posts.</p> <p>4. Diplomatic Inspector performs his duties and responsibilities in independent and</p>	<p>osobljem diplomatskih i konzularnih misijama za potrebe inspekcije;</p> <p>3.4. Savetuje Ministra Inostranih Poslova i Generalnog Sekretara o zakonitosti, delotvornosti i efikasnosti diplomatskih i konzularnih misija i profesionalne etike među zaposlenima;</p> <p>3.5. Razvija i dostavlja Ministru Inostranih Poslova i Generalnom Sekretaru svake kalendarske godine, a najkasnije do 1 marta svake godine, izvještaj o radu i organizaciji diplomatskih i konzularnih misija i kako da koriste ljudske i finansijske resurse;</p> <p>3.6. U slučaju da se nađe prekršaj ili loše upravljanje sa ljudskim i finansijskim resursa u jednom ili više diplomatskih ili konzularnim misijama, odmah prijavi Ministru Inostranih Poslova i Generalnom Sekretaru svoje nalaze;</p> <p>3.7. Preporučuje Ministru Inostranih Poslova i Generalni Sekretaru potrebne mere za poboljšanje organizacije i rada diplomatskim i konzularnim misijama.</p> <p>4. Diplomatski Inspektor obavlja dužnosti i odgovornosti nezavisno i nepristrasno.</p>
---	--	---

<p>paanshme.</p> <p>5. Ministri i Punëve të Jashtme dorëzon një raport vjetor në Qeveri, Presidencë dhe Kuvend të Kosovës për punën dhe gjetjet e Inspektorit Diplomatik, si dhe masat që i ka ndërmarrë Ministria e Punëve të Jashtme sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të Inspektorit Diplomatik. Raporti dorëzohet jo më vonë se me 1 mars të çdo viti kalendarik për vitin paraprak.</p> <p>6. Procedura e inspektimit të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore përcaktohet me akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 12 Protokolli i Shtetit</b></p> <p>1. Protokolli i Shtetit është pjesë përbërëse e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, përkatësisht e Ministrisë së Punëve të Jashtme.</p> <p>2. Organizimi, funksionimi dhe detyrat e Protokollit të Shtetit rregullohen me ligj të veçantë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 13 Akademia Diplomatike</b></p> <p>1. Akademia Diplomatike është njësi organizative e Ministrisë së Punëve të Jashtme e cila vepron si program i veçantë buxhetor në</p>	<p>impartial manner.</p> <p>5. Minister of Foreign Affairs submits an annual report to the Government, the Presidency and Kosovo Assembly about the work and findings of Diplomatic Inspector, and about the measures undertaken by the Ministry of Foreign Affairs upon the findings and recommendations of the Diplomatic Inspector. The report should be submitted not later than 1<sup>st</sup> of March of each calendar year for the previous year.</p> <p>6. The procedure of inspection of diplomatic missions and consular posts is determined by the sublaw act.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 12 State Protocol</b></p> <p>1. State Protocol is an integral part of the Foreign Service of the Republic of Kosovo, respectively of the Ministry of Foreign Affairs.</p> <p>2. Organization, functioning and duties of the State Protocol are regulated by the special law.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 13 Diplomatic Academy</b></p> <p>1. Diplomatic Academy is an organizational unit of the Ministry of Foreign Affairs that operates as special budgetary program within</p>	<p>5. Ministar Inostranih Poslova podnosi godišnji izveštaj Vladi, Predsedniku i Skupština Kosova o radu i nalazima diplomatskog inspektora, kao i mere koje je Ministarstvo Inostrnaih Poslova u skladu sa nalazima i preporukama Diplomatskog Inspektora. Izveštaj se dostavi najkasnije do 1 marta svake kalendarske godine za prethodnu godinu.</p> <p>6. Procedure o inspekciji diplomatskih misija i konzularnih predstavništva definišu se sa podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 12 Državni Protokol</b></p> <p>1. Državni Protokol je sastavni deo Inostrane Službe Republike Kosovo, odnosno Ministarstva Inostranih Poslova.</p> <p>2. Organizacija, funkcija i zadatci Državnog Protokola se regulišu sa posegnim zakonom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 13 Diplomatska Akademija</b></p> <p>1. Diplomatske akademije je organizaciona jedinica Ministarstva Inostranih Poslova koja posluje kao poseban program bunžeta u okviru</p>
---	---	---

<p>kuadër të Ministrisë.</p> <p>2. Akademia Diplomatike e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të nëpunëseve të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës. Sipas nevojave dhe mundësive, Akademia Diplomatike mund të angazhohet edhe në përgatitjen dhe zhvillimin profesional në fushën e diplomacisë dhe politikës së jashtme të nëpunëseve dhe zyrtarëve të tjerë shtetëror të Republikës së Kosovës, si dhe të personave të tjerë jashtë institucioneve të Republikës së Kosovës, nëse kjo është në interesin e Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Akademia udhëhiqet nga Drejtori, i cili është përgjegjës për administrimin, funksionimin dhe menaxhimin e këtij institucioni. Drejtori emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Punëve të Jashtme.</p> <p>4. Buxheti i Akademisë Diplomatike sigurohet nga Ministria e Punëve të Jashtme. Akademia Diplomatike mund të ofrojë shërbimet e saj me pagesë si dhe të jetë përfituese e donacioneve.</p> <p>5. Struktura organizative e Akademisë Diplomatike përcaktohet me akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 14</b> <b>Programi i Bursave i Ministrisë së Punëve të Jashtme</b></p>	<p>the Ministry.</p> <p>2. Diplomatic Academy of the Republic of Kosovo is responsible for the preparation and professional development of employees of the Foreign Service of the Republic of Kosovo. Upon the needs and possibilities, Diplomatic Academy, may also engage in preparation and professional development in the field of diplomacy and foreign policy of the employees and other state officials of the Republic of Kosovo, and other persons beyond institutions of the Republic of Kosovo, if this is in the interest of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Academy is headed by the Director, who is responsible for the administration, functioning and management of this institution. Director is appointed and discharged by the Minister of Foreign Affairs.</p> <p>4. The budget of the Diplomatic Academy is provided by the Ministry of Foreign Affairs. Diplomatic Academy may provide its services with pay, and benefit from donations.</p> <p>5. The organizational structure of the Diplomatic Academy is determined by the sublaw act.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 14</b> <b>Scholarship Program of the Ministry of Foreign Affairs</b></p>	<p>Ministarstva.</p> <p>2. Diplomatska Akademija Republike Kosovo je odgovorna za razvoj i profesionalnu pripremu zaposlenih u diplomatskoj službi Republike Kosovo. U skladu sa potrebama i mogućnostima, Diplomatske Akademija može biti također uključena u pripremu i profesionalni razvoj u oblasti diplomatije i službenika za vanjsku politiku i drugih vladinih zvaničnika Republike Kosovo i druge osobe izvan institucija Republike Kosovo, ako je to u interesu Republike Kosovo.</p> <p>3. Akademija se vodi od Direktora, koji je odgovoran za rad i upravljanje ove institucije. Direktora imenuje i otpušta Ministar Inostranih Poslova.</p> <p>4. Diplomatske Akademije budžet se osigura od strane Ministarstva Inostranih Poslova. Diplomatske Akademija može da nudi svoje službe i na natplatu, i da bude koristi donacije.</p> <p>5. Organizativna struktura Diplomatske Akademije određuje se podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 14</b> <b>Program Fonda za Stipendije Ministarstva Inostranih Poslova</b></p>
---	---	--

<p>1. Ministria e Punëve të Jashtme ka programin e veçantë për ndarjen e bursave shtetasve të huaj për studime ose aktivitete të tjera akademike në Republikën e Kosovës kur kjo është në interes të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Programi drejtohet nga Komisioni i Fondit, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të përcaktuar me vendim të Ministrit të Punëve të Jashtme. 3 (Tre) anëtarë duhet të jenë diplomatë të karrierës me gradën jo më pak se Këshilltar Ministër, 1 (një) duhet të jetë përfaqësues i Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Kulturë dhe 1 (një) përfaqësues i shoqërisë civile. Kryesuesi i Komisionit të Fondit koordinon mbarëvajtjen e programit të bursave sipas politikave të përcaktuara nga Ministri i Punëve të Jashtme.</p> <p>3. Programi financohet nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe nga donacionet. Maksimalisht 0.5 (zero.pesë) për qind e buxhetit vjetor të Ministrisë së Punëve të Jashtme ndahen për këtë qëllim.</p> <p>4. Kriteret dhe procedurat për ndarjen e bursave përcaktohen me akt nënligjor.</p>	<p>1. Ministry of Foreign Affairs has the special program for allocation of scholarships to foreign citizens for studies or other academic activities in the Republic of Kosovo when this is in the interest of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The program is managed by the Fund Commission, which consists of five (5) members assigned by the decision of the Minister of Foreign Affairs. 3 (three) members must be career diplomats with the rank of not less than Minister Counselor, 1 (one) must be representative of the Ministry of Education, Science and Culture, and 1 (one) representative of civil society. The Chairman of the Fund Commission coordinates the progress of the scholarship program according to the policies determined by the Minister of Foreign Affairs.</p> <p>3. The program is financed from the budget of the Ministry of Foreign Affairs and from donations. Maximally 0.5 (zero.five) percent of the annual budget of the Ministry of Foreign Affairs is allocated for this purpose.</p> <p>4. The criteria and procedures for allocation of scholarships are determined by the sublaw act.</p>	<p>1. Ministarstvo Inostranih Poslova ima poseban program za stipendije stranim državljanima za studije ili druge akademske aktivnosti u Republici Kosovo, kada je to u interesu Republike Kosovo.</p> <p>2. Program se upravlja od Komisije za Fond, koja se sastoji od 5 (pet) članova koje imenuje Ministar Inostranih Poslova. 3 (Tri) koji moraju biti diplomata karijeru sa činom ne manje od Savetnik Ministra, 1 (jedan) treća da bude predstavnik Ministarstva Obrazovanja Nauke i Kulture i 1 (jedan) predstavnik od civilnog društva. Predvodilac Komisije za fond koordinira napredak programa stipendiranja po određenim politikama od Ministra Inostranih Poslova.</p> <p>3. Program se finansira iz budžeta Ministarstva Inostranih Poslova i iz donacija. Maksimalno pola 0.5 (nula.pet) posto godišnjeg budžeta Ministarstva Inostranih Poslova deli se za ovaj cilj.</p> <p>4. Kriteriji i procedure za dodelu stipendija utvrđuje se podzakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 15</b> <b>Struktura Organizative e Ministrisë</b></p> <p>Struktura organizative e Ministrisë së Punëve të Jashtme përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 15</b> <b>Organizational Structure of the Ministry</b></p> <p>Organizational structure of the Ministry of Foreign Affairs is determined by the sublaw act approved by the Government of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 15</b> <b>Organizativna Struktura Ministarstva</b></p> <p>Organizaciona struktura Ministarstva Inostranih Poslova utvrđuje podzakonskim aktom odobren od strane Vlade Republike Kosovo.</p>

<p style="text-align: center;"><b>Neni 16</b> <b>Siguria e sistemit informativ dhe të telekomunikacionit</b></p> <p>1. Ministria e Punëve të Jashtme zbaton dhe mirëmban teknologji informative e cila siguron komunikim të sigurt midis Ministrisë së Punëve të Jashtme, misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Standardi dhe kriteret e pajisjeve të teknologjisë informative sipas paragrafit 1 të këtij neni përcaktohen me vendim të Qeverisë.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 16</b> <b>Security of information system and telecommunications</b></p> <p>1. Ministry of Foreign Affairs implements and maintains information technology which ensures secure communication between the Ministry of Foreign Affairs, diplomatic missions and consular posts of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Standard and criteria of the information technology equipment, according to the paragraph 1 of this Article are determined by the Government decision.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 16</b> <b>Bezbednost informativnog sistema i telekomunikacije</b></p> <p>1. Ministarstvo Inostranih Poslova, u okviru svojih tehničkih i finansijskih, odlučuje, implementira i održava informacijske tehnologije koja osigurava sigurnu komunikaciju između Ministarstva Inostranih Poslova, diplomatske i konzularne misije Republike Kosovo.</p> <p>2. Standard i kriteriji o tehnološkoj informativnoj aparaturi određuje se po stavu 1 ovog člana utvrđuje sa odlukom Vlade.</p>
<p><b>KAPITULLI III</b> <b>MISIONET DIPLOMATIKE DHE POSTET KONSULLORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS</b></p>	<p><b>CHAPTER III</b> <b>DIPLOMATIC MISSIONS AND CONSULAR POSTS OF THE REPUBLIC OF KOSOVO</b></p>	<p><b>POGLAVLJE III</b> <b>DIPLOMATSKE MISIJE I KONZULARNA PREDSTAVNIŠTVA REPUBLIKE KOSOVO</b></p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 17</b> <b>Hapja dhe mbyllja e Misioneve Diplomatiqe dhe Posteve Konsullore</b></p> <p>1. Presidenti dekreton hapjen dhe mbylljen e misioneve diplomatike dhe të posteve konsullore të Republikës së Kosovës në bazë të konsultimit me Kryeministrin.</p> <p>2. Misionet diplomatike dhe postet konsullore veprojnë nën mbikëqyrjen dhe në pajtim me</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 17</b> <b>Opening and closing of the Diplomatic Missions and Consular Posts</b></p> <p>1. The President decrees the opening and closing of diplomatic missions and consular posts of the Republic of Kosovo based on the consultation with the Prime Minister.</p> <p>2. Diplomatic missions and consular posts operate under the supervision and in</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 17</b> <b>Otvaranje i zatvaranje Diplomatskih Misija i Konzularnih Predstavništva</b></p> <p>1. Predsednik uredbom otvara i zatvara diplomatsku misiju i konzularna predstavništva Republike Kosovo u konsultaciji s Premijerom.</p> <p>2. Diplomatske i konzularne misije će raditi pod nadzorom i u skladu sa smernicama Ministarstva Inostranih Poslova.</p>



<p>civil.</p> <p>4. Personeli teknik dhe i shërbimit në misionet diplomatike dhe postet konsullore nuk është pjesë e Shërbimit të Jashtëm dhe punësimi i tyre bëhet sipas ligjit të punës të shtetit pranues.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 36</b> <b>Kërkesat për pranimin si diplomat i karrierës</b></p> <p>1. Si diplomat i karrierës pranohen personat të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, si dhe kërkesat e posaçme, si më poshtë:</p> <p>1.1. Të kenë të përfunduar shkollimin universitar;</p> <p>1.2. Të kenë njohuri të certifikuar të paktën të një gjuhe zyrtare të Kombeve të Bashkuara;</p> <p>1.3. Të mos jenë anëtarë në një parti politike ose të ndonjë subjekti tjetër politik.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Pranimi në Shërbimin e Jashtëm si Diplomat i Karrierës</b></p> <p>1. Pranimi në Shërbimin e Jashtëm si diplomat i karrierës bëhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, në përputhje me procedurat e përcaktuara me akt nënligjor.</p>	<p>on civil service.</p> <p>4. Technical and service personnel of diplomatic missions and consular posts are not part of the Foreign Service and their employment is done according to the labor law of the host country.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 36</b> <b>Requirements for admission as career diplomat</b></p> <p>1. As career diplomat, are admitted the persons who meet general requirements of admission in the civil service, as well as special requirements, as follows:</p> <p>1.1. Have completed university education;</p> <p>1.2. Have certified knowledge of at least one official language of the United Nations;</p> <p>1.3. Not to be members of political party or any other political entity.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>Admission to Foreign Service as Career Diplomat</b></p> <p>1. Admission to Foreign Service as career diplomat is done through open competition, in accordance to the procedures determined by the sublaw act.</p>	<p>4. Tehničkog i servis osoblja u diplomatskim i konzularnim misijama nije deo Inostrane Službe i posao se vrši u skladu sa zakonom o radu države prijema.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 36</b> <b>Zahtev za prijem kao diplomata karijere</b></p> <p>1. Kao diplomata private se osobe koje ispunjavaju opšte uslove podobnosti u državnoj službi, kao i posebne zahteve, kako sledi:</p> <p>1.1. Da su završili visoko obrazovanje;</p> <p>1.2. Da imaju znanje najmanje jednog od službenih jezika Ujedinjenih Nacija ili Evropske Unije;</p> <p>1.3. Da nisu članovi neke političke stranke ili bilo koje druge političkog subjekta.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Prijem u Inostranoj Službi kao Diplomata Karijere</b></p> <p>1. Prijem u diplomatsku službu kao diplomata je putem javnog konkursa u skladu sa postupcima utvrđenim podzakonskim aktom.</p>
---	---	---

<p>2. Pas përfundimit të procedurës së konkurrimit, kandidati duhet të kalojë me sukses periudhën e provës në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve. Kandidati, gjatë periudhës së provës, përveç kryerjes së ciklit të detyrueshëm të trajnimit me akt nënligjor, trajnohet në të gjitha strukturat e Ministrisë së Punëve të Jashtme.</p> <p>3. Në përfundim të periudhës së provës, kandidati i nënshtrohet provimit të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me Akademinë Diplomatike, rezultati i të cilit përcakton pranimin ose mospranimin e tij në sistemin e karrierës diplomatike, si dhe strukturën e Shërbimit të Jashtëm ku ai punësohet.</p> <p>4. Në rastet kur është me interes për Republikën e Kosovës, një ambasador i emëruar jashtë sistemit të karrierës diplomatike me kërkesën e tij mund të kalojë në Shërbimin e Jashtëm si diplomat i karrierës me kusht që të kalojë me sukses provimin pranues të organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me Akademinë Diplomatike. Në këtë rast, me vendim të Ministrit të Punëve të Jashtme kandidati pranohet në Shërbimin e Jashtëm si diplomat i karrierës me gradën diplomatike jo më pak se Ministër Këshilltar.</p> <p>5. Përmbajtja dhe procedura e provimit sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor.</p>	<p>2. Upon completion of the competition procedures, the candidate must successfully pass the probationary period of 2 (two) years. Candidate, during the probationary period, besides performing compulsory training cycle upon sublaw act, is trained at all structures of the Ministry of Foreign Affairs.</p> <p>3. At the end of the probationary period, the candidate is subject of examination organized by the Ministry of Foreign Affairs, in cooperation with the Diplomatic Academy, whose outcome determines his admission or rejection to the diplomatic career system and to the structure of Foreign Service where he is employed.</p> <p>4. In cases, when is of interest to the Republic of Kosovo, an ambassador appointed beyond the diplomatic career system, at his request, may pass to the Foreign Service provided that successfully passes the admission examination organized the Ministry of Foreign Affairs, in cooperation with Diplomatic Academy. In this case, by the decision of the Minister of Foreign Affairs, the candidate is admitted in the Foreign Service as career diplomat with diplomatic rank not less than the Minister Counselor.</p> <p>5. Content and examination procedure in accordance to the paragraph 3 and 4 of this Article are determined by the sublaw act.</p>	<p>2. Po završetku konkursa, kandidat mora uspješno proći probni period od 2 (dve) godine. Kandidat za vreme probnog perioda, osim obavljanja obavezan ciklus treninga sa Pravilnikom, obuče se u svim strukturama Ministarstva Inostranih Poslova.</p> <p>3. Na kraju probnog perioda, kandidat polaže ispit organizovan od strane Ministarstva Inostranih Poslova, u saradnji s Diplomatsom Akademijom, čiji rezultat određuje prihvatanje ili odbijanje diplomatsku karijeru u sistem i strukture Inostrane Službe dje je zaposlen.</p> <p>4. Kada je od interesa za Republiku Kosovo, jedan ambasador imenovani izvan diplomatske karijere sa njegovim zahtjevom može proći u diplomatskoj službi kao diplomata pod karijeru uslovom da uspješno pređe prijemni ispit u organizaciji Ministarstva Inostranih Poslova, u suradnji s Diplomatskom Akademijom. U ovom slučaju, odluka Ministra Inostranih Poslova kandidata se prihvati u Inostrane službe kao diplomata sa diplomatskim činom ne manje od Ministra Savjetnik.</p> <p>5. Sadržaj i procedure ispitivanja bi će iz stava 3. i 4. ovog člana utvrđuje se podzakonskim aktom.</p>
---	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 38</b> <b>Transferimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë</b></p> <p>1. Transferimi dhe lëvizja paralele e diplomatit të karrierës bëhet me vendim të Ministrisë të Jashtëm, bazuar në nevojat dhe kërkesat objektive të përfaqësimit diplomatik dhe gradat e diplomatit të karrierës. Procedurat e transferimit dhe të lëvizjes paralele përcaktohen me akt nënligjor.</p> <p>2. Ngritja në detyrë e diplomatit të karrierës bëhet me vendim të Ministrisë të Jashtëm, sipas sistemit të gradimit të përcaktuar me këtë ligj dhe në bazë të vlerësimeve profesionale të Komisionit të Karrierës Diplomatike. Vendimi i Ministrisë për ngritje në detyrë të një diplomati të karrierës duhet të jetë i arsyetuar mbi kriteret objektive për të cilat diplomati i karrierës i është nënshtruar një monitorimi dhe vlerësimi nga Komisioni i Karrierës Diplomatike, kriteret të cilat përcaktohen me akt nënligjor. Kriteret e tilla duhet të sigurojnë që ngritja në detyrë për diplomatin e karrierës i nënshtrohet parimit të meritës dhe profesionalizmit, të verifikuar përmes një procedure të rregullt dhe të arsyetuar. Përgjatë nga kjo përbën procedura për emërimin e krerëve të misioneve diplomatike sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 38</b> <b>Transfer, parallel movement, promotion</b></p> <p>1. Transfer and parallel movement of the career diplomat is done by the decision of the Minister of Foreign Affairs, based on the needs and objective requirements of diplomatic representation and the ranks of career diplomat. Procedures of transfer and parallel movement are determined by the sublaw act.</p> <p>2. Promotion of career diplomat is done by the decision of the Minister of Foreign Affairs, according to the grading system determined by this law and based on professional assessments of Diplomatic Career Commission. The decision of the Minister for the promotion of a career diplomat must be justified on objective criteria to which, the career diplomat was subjected to a monitoring and evaluation by the Diplomatic Career Commission, which criteria are determined by the sublaw act. Such criteria should ensure that promotion of career diplomat is subject to the principle of merit and professionalism, verified through a regular and justified procedure. Exception to this is the procedure for the appointment of heads of diplomatic missions according to the Constitution of the Republic of Kosovo.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 38</b> <b>Transferi, paralelna kretanja, avansiranje</b></p> <p>1. Transfer, paralelno kretanje i avansiranje diplomata od karijere koje je Ministar Inostranih Poslova, na predlog Generalnog Sekretara. U svakom slučaju, predlog je u pratnji i uz podršku o ocjenjivanju rada direktno od diplomata karijere.</p> <p>2. Napredovanje na dužnosti diplomata od karijere sa odlukom Ministra Inostranih Poslova, prema sistemu činova predviđenim ovim zakonom i na osnovu profesionalne procene Diplomatske Komisije o Karijeri. Odluka Ministra za napredovanje Diplomate mora biti opravdana na objektivnim kriterijima koji diplomata je podvrgnut praćenju i evaluaciji od strane Komisije za Diplomatsku Karijeru, kriteriji utvrđeni statutom. Takvi kriteriji trebaju osigurati da napredovanje diplomata u skladu sa principom zasluge i profesionalizma, ovjeren kroz redovne procedure i obrazložene. Izuzetak je procedura za imenovanje šefova diplomatskih misija u skladu sa Ustavom Republike Kosovo.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 39</b> <b>Verifikimi i sigurisë dhe konfidencialiteti</b></p> <p>1. I gjithë personeli i Shërbimit të Jashtëm i</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 39</b> <b>Verification of security and confidentiality</b></p> <p>1. All personnel of the Foreign Service are</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 39</b> <b>Verifikacija sigurnosti i poverljivosti</b></p> <p>1. Svo osoblje službe u inostranstvu je</p>

<p>nënshtrohet verifikimit të sigurisë sipas ligjit në fuqi.</p> <p>2. Me fillimin e punës në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, secili nëpunës i Shërbimit të Jashtëm ka për detyrë që të nënshkruaj një deklaratë të konfidencialitetit përmes të cilës deklarohet se gjatë tërë kohës që është i punësuar në Shërbimin e Jashtëm, si dhe për një periudhë kohore prej 5 (pesë) viteve pas përfundimit të punësimit në Shërbimin e Jashtëm, nuk do të deklarohet dhe nuk do të shpalojë asnjë informacion të klasifikuar lidhur me punën e tij në Shërbimin e Jashtëm apo ndonjë informacion tjetër të klasifikuar që ka të bëjë me Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit nuk zbatohet në rast se nëpunësi i Shërbimit të Jashtëm autorizohet nga eprori i tij ose kur dhënia e informacionit është e detyrueshme sipas ligjit në fuqi. Mos nënshkrimi i deklaratës së konfidencialitetit dhe mos ruajtja e konfidencialitetit janë shkak për shkarkim nga detyra dhe për marrjen e masave të tjera disiplinore dhe ligjore.</p> <p><b>KAPITULLI V STATUSI I DIPLOMATIT TË KARRIERËS</b></p> <p><b>Neni 40 Zhvillimi i karrierës diplomatike</b></p> <p>1. Pas përfundimit me sukses të provimit për</p>	<p>subject to security verification in accordance to the applicable law.</p> <p>2. With the start of duty at the Foreign Service of the Republic of Kosovo, each Foreign Service employee is obliged to sign a confidentiality declaration through which declares that during the entire period of employment in the Foreign Service, and for a period of 5 (five) years after termination of employment at the Foreign Service, will not declare and not disclose any classified information related to his work in the Foreign Service or any other classified information that has to do with the Foreign Service of the Republic of Kosovo. The obligation to keep confidentiality does not apply if the Foreign Service employee is authorized by his superior or when the given information is required in accordance to the applicable law. Failure to sign the declaration of confidentiality and failure to safeguard confidentiality are reason for dismissal and for taking other disciplinary and legal measures.</p> <p><b>CHAPTER V STATUS OF THE CAREER DIPLOMAT</b></p> <p><b>Article 40 Development of diplomatic career</b></p> <p>1. After successful completion of the</p>	<p>predmet sigurnosne provjre prema važećem zakonu.</p> <p>2. U početku rada u Inostranoj Službi Republike Kosovo, svaki službenik Inostrane Službe ima obavezu da potpišu izjavu povjerljivosti kroz koji je izjavio da je tokom cijelog vremena kojeg je zaposlen u Inostranoj Službi, i za period od 5 godina nakon prestanka radnog odnosa u Inostranoj Službi, neće proglašiti i neće otkrivati povjerljive informacije povezan sa njegov rad u Inostranoj Službi ili bilo koje druge povjerljivih informacija koje ima veze sa Inostranim Službama Republike Kosovo. Obaveza poverljivosti se ne primjenjuje ako je službeniku je odobreno od strane svog nadređenog ili kada je potrebno objavljivanje prema važećem zakonu. Propust da potpišu izjavu o povjerljivosti i nedostatak povjerljivosti dospijevaju za razrješenje i drugih mjera disciplinske i pravnih.</p> <p><b>POGLAVLJE V STATUS DIPLOMATA KARIJERE</b></p> <p><b>Član 40 Razvoj diplomatske karijere</b></p> <p>1. Po uspešnom završetku ispita za upis u</p>
--	--	---

<p>pranim në Shërbimin e Jashtëm si diplomat i karrierës, kandidati e fiton statusin e diplomatit të karrierës me gradën diplomatike Atashe.</p> <p>2. Në rastet kur kandidati ka mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune dhe ka kualifikim të lartë akademik, atij i mundësohet që pas përfundimit me sukses të provimit për pranim në Shërbimin e Jashtëm si diplomat i karrierës të fitojë statusin e diplomatit të karrierës me gradë diplomatike më të lartë se Atashe. Me akt nënligjor përcaktohet barasvlera e përvojës së punës dhe e kualifikimit diplomatik me gradën diplomatike.</p> <p>3. Diplomati i karrierës caktohet në pozicione në Ministrinë e Punëve të Jashtme duke respektuar hierarkinë e gradave diplomatike, si më poshtë. Barasvlera e pozicioneve të Ministrisë së Punëve të Jashtme sipas gradës diplomatike përcaktohet me akt nënligjor.</p>	<p>examination for admission to the Foreign Service as career diplomat, the candidate obtains the status of career diplomat with diplomatic rank Attaché.</p> <p>2. In cases where the candidate has over 10 (ten) years of working experience and has high academic qualification, it is enabled to him that after the successful completion of the exam for admission to the Foreign Service as a career diplomat to acquire the status of career diplomat with diplomatic rank higher than Attaché. The equivalence of work experience and diplomatic qualification with diplomatic rank is determined by the sublaw act.</p> <p>3. Career diplomat is appointed to the positions in the Ministry of Foreign Affairs respecting the hierarchy of diplomatic ranks, as follows. Equivalence of positions of the Ministry of Foreign Affairs in accordance with diplomatic rank is determined by the sublaw act.</p>	<p>Inostrane Službe kao diplomata karijere, kandidat dobije status diplomata od karijere sa diplomatskim činom Atašea.</p> <p>2. U slučajevima kada kandidat ima više od deset (10) godina iskustva i visoke akademske kvalifikacije, dozvoljeno je da se nakon uspešno završenog ispita za prijem u Inostranu Službu kao diplomata da stekne status diplomata sa diplomatski čin veći od Atašea. Podzakonskim aktom utvrditi ekvivalencije radnog iskustva i diplomatske kvalifikacija diplomatski čin.</p> <p>3. Diplomata karijere imenuje se na položaje u Ministarstvu Inostranih Poslova poštujući hijerarhiju diplomatskih redova, kako sledi. Jednakost pozicija Ministarstva Inostranih Poslova u okviru diplomatskom rangi određuje se podzakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 41</b> <b>Gradat diplomatike dhe konsullore</b></p> <p>1. Diplomatët e karrierës, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në Shërbimin e Jashtëm marrin grada diplomatike ose konsullore.</p> <p>2. Gradat diplomatike në Shërbimin e Jashtëm, sipas hierarkisë së gradave, janë:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Ambasador;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 41</b> <b>Diplomatic and consular ranks</b></p> <p>1. Career diplomats, while exercising their functions at the Foreign Service, obtain diplomatic or consular ranks.</p> <p>2. Diplomatic ranks of the Foreign Service, in accordance to the hierarchy of ranks, are:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Ambassador;</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 41</b> <b>Diplomatski i konzularni činovi</b></p> <p>1. Diplomate u karijeri, u obavljanju svojih funkcija u diplomatsku službu dobijaju diplomatskih ili konzularnih činove.</p> <p>2. Diplomatski činovi u Inostranoj Službi, po hirarhiji činova, su:</p> <p style="padding-left: 20px;">2.1. Ambasador;</p>

<p>2.2. Ministër Fuqplotë;</p> <p>2.3. Ministër Këshilltar;</p> <p>2.4. Këshilltar;</p> <p>2.5. Sekretar i Parë;</p> <p>2.6. Sekretar i Dytë;</p> <p>2.7. Sekretar i Tretë;</p> <p>2.8. Atashe.</p>	<p>2.2. Plenipotentiary Minister;</p> <p>2.3. Minister Counselor;</p> <p>2.4. Counselor;</p> <p>2.5. First Secretary;</p> <p>2.6. Second Secretary;</p> <p>2.7. Third Secretary;</p> <p>2.8. Attaché.</p>	<p>2.2. Punomoćnik Ministar;</p> <p>2.3. Savetnik Ministar;</p> <p>2.4. Savetnik;</p> <p>2.5. Prvi Sekretar ;</p> <p>2.6. Drugi Sekretar ;</p> <p>2.7. Treći Sekretar ;</p> <p>2.8. Atashe.</p>
<p>3. Gradat konsullore në Shërbimin e Jashtëm, sipas hierarkisë së gradave, janë:</p> <p>3.1. Konsull i Përgjithshëm;</p> <p>3.2. Konsull;</p> <p>3.3. Zëvendës Konsull;</p> <p>3.4. Agjent Konsullor.</p>	<p>3. Consular ranks of the Foreign Service in accordance to the hierarchy of ranks, are:</p> <p>3.1. Consul General;</p> <p>3.2. Consul;</p> <p>3.3. Vice Consul;</p> <p>3.4. Consular Agent.</p>	<p>3. Konsularna zvanja u Inostranoj Službi po činovskoj hirarhiji su:</p> <p>3.1. Generalni Konsul;</p> <p>3.2. Konsul;</p> <p>3.3. Zamenik Konsul;</p> <p>3.4. Agent Konsul.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 42</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Punësimi jashtë Shërbimit të Jashtëm</b></p> <p>1. Diplomati i karrierës mund të punësohet në pozicione që mbulojnë marrëdhëniet me jashtë në institucionet shtetërore pas marrëveshjes përkatëse ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe këtyre institucioneve.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 42</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Employment beyond the Foreign Service</b></p> <p>1. Career diplomat may be employed in state institutions at the positions that cover foreign relations after the relevant agreement between the Ministry of Foreign Affairs and these institutions.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 42</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Zapošljavanje van Inostrane Službe</b></p> <p>1. Diplomata u Karijeri mogu biti zaposleni u položajima koji pokrivaju inostrane odnose državnih institucija nakon odgovarajućih sporazuma između Ministarstva Inostranih Poslova i institucija.</p>

<p>2. Diplomati i karrierës mund të delegohet ose të punësohet në organizatat ndërkombëtare ose mekanizmat tjera shumëpalëshe për periudha të përkohshme, pas miratimit nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe me marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe diplomatit në fjalë. Kjo periudhë është vijim i pandërprerë i statusit të diplomatit të karrierës.</p> <p>3. Periudha e punësimit në detyrat e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni merret në konsideratë për efekt të llogaritjes së afatit kohor të nevojshëm për përfitimin e gradave diplomatike.</p> <p>4. Me mbarimin e detyrës në institucionet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, diplomati i karrierës ka të drejtë të rikthehet në Shërbimin e Jashtëm, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.</p> <p>5. Procedurat e punësimit të parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor.</p>	<p>2. Career diplomat may be delegated or be employed at international organizations or other multilateral mechanisms for temporary periods, after approval of the Minister of Foreign Affairs and by the agreement between the Ministry of Foreign Affairs and the said diplomat. This period is the uninterrupted continuation of the status of the career diplomat.</p> <p>3. The period of employment on the duties referred in paragraph 1 and 2 of this Article shall be taken into consideration in order to calculate the time period necessary for obtaining diplomatic ranks.</p> <p>4. Upon completion of the duty in the institutions referred in paragraph 1 and 2 of this Article, career diplomat has the right to return to the Foreign Service in accordance to the relevant agreements.</p> <p>5. Employment procedures envisaged in paragraph 1 and 2 of this Article are determined by the sublaw act.</p>	<p>2. Diplomata u karijeri može preneti ili biti zaposleni u međunarodnim organizacijama ili drugim multilateralnim mehanizmima za privremeni period, nakon odobrenja od strane Ministra Inostranih Poslova i ugovora između Ministarstva Inostranih Poslova i navedenog diplomate. Ovaj period je neprekinuti nastavak statusa diplomata karijere.</p> <p>3. Period zaposlenja u poslove iz stava 1. i 2.ovog člana uzima se u obzir za izračunavanje vremenski period, potrebno za dobivanje diplomatskih činova.</p> <p>4. Po završetku zadatka u institucijama navedenih u stavovima 1 i 2 ovog člana, diplomata ima pravo da se vrati u Inostranoj Službi, u skladu sa odgovarajućim ugovorima.</p> <p>5. Procedure zapošljavanja predviđenim u stavovima 1 i 2 ovog člana utvrđuje se podzakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 43</b> <b>Caktimi në detyrë dhe mbarimi i detyrës në misionet diplomatike dhe postet konsullore</b></p> <p>1. Diplomatat e karrierës caktohen në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Kosovës nga Ministri i Punëve të Jashtme, pasi kanë marrë gradën e parë</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 43</b> <b>The assignment on duty and termination of duty at diplomatic missions and consular posts</b></p> <p>1. Career diplomats are assigned to diplomatic missions and consular posts of the Republic of Kosovo by the Minister of Foreign Affairs, after obtaining the first diplomatic rank of</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 43</b> <b>Imenovanje i završetak dužnosti u diplomatskim misijama i konzularna predstavništva</b></p> <p>1. Diplomate u karijeru određuju se po diplomatskim misijama i konzularnim Republike Kosovo od strane Ministra Inostranih Poslova, nakon primanja prvog</p>

<p>diplomatike “Atashe”.</p> <p>2. Diplomatët e karrierës qëndrojnë me shërbim në një mision diplomatik ose post konsullor jo më shumë se 4 (katër) vjet, përveç në rastin e paraparë në nenin 25, paragrafi 4, i këtij ligji. Pas përfundimit të shërbimit jashtë vendit, diplomatët e karrierës mund të caktohen me detyrë në një mision diplomatik ose post konsullor vetëm pasi të kenë shërbyer për të paktën 2 (dy) vjet në Shërbimin e Jashtëm brenda vendit.</p> <p>3. Procedurat e caktimit dhe mbarimit të detyrës në misionet diplomatike ose postet konsullore përcaktohen me akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 44</b> <b>Mbarimi i parakohshëm i funksionit dhe transferimi i Kreut dhe personelit të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore</b></p> <p>1. Ministri i Punëve të Jashtme urdhëron mbarimin e parakohshëm të funksionit, ose transferimin e Kreut të misionit diplomatik ose postit konsullor, si dhe të çdo anëtarit tjetër të personelit të misionit diplomatik ose postit konsullor, për arsyt e mëposhtme:</p> <p>1.1. Kur një gjë e tillë kërkohet nga shteti pritës;</p> <p>1.2. Kur ai ose anëtarët e familjes së tij kryejnë veprime që janë në kundërshtim me politikën e jashtme dhe cenojnë imazhin e</p>	<p>“Attaché”.</p> <p>2. Career diplomats remain in service at the same diplomatic mission or consular post no more than 4 (four) years, except in the case foreseen in Article 25, paragraph 4, of this law. Upon completion of the service abroad, career diplomats may be assigned on duty in a diplomatic mission or consular post, only after they have served at least 2 (two) years in the Foreign Service inside the country.</p> <p>3. Procedures of appointment and termination of duty at diplomatic missions or consular posts are determined by the sublaw act.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 44</b> <b>Early termination of the function and transfer of the head and the personnel of diplomatic missions and consular posts</b></p> <p>1. Minister of Foreign Affairs orders early termination of the function, or transfer of the head of diplomatic mission or consular post, as well as any other member of the personnel of diplomatic mission or consular post, for the following reasons:</p> <p>1.1. When such action is required by the host country;</p> <p>1.2. When he or his family members perform actions that are contrary to the foreign policy and violating the image of</p>	<p>diplomatskog čina “Atašea”.</p> <p>2. Diplomati u karijeri ostaće u službi u isto diplomatskoj misiji ili konzularnoj poziciji ne više od 4 (četiri) godine, osim u slučaju predviđenom u članu 25 stav 4 ovog zakona. Po završetku službe u inostranstvu, diplomate mogu biti dodeljeni na dužnosti u diplomatskoj misiji ili konzularnom predstavništvu tek nakon što su služili za najmanje 2 (dve) godine u diplomatskoj službi u zemlji.</p> <p>3. Procedure za imenovanje i završetak dužnosti u diplomatskim misijama ili konzularnim predstavništvima predviđase sa podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 44</b> <b>Preвременi prekid funkcije i transfer šefa i osoblja diplomatskih misija i konzularnih predstavništva</b></p> <p>1. Ministar Inostranih Poslova da nalog za rani prekid, ili transfer šefa diplomatske misije ili konzularnog predstavništva, kao i bilo koji drugi član osoblja diplomatske misije ili konzularnog predstavništva, iz sledećih razloga:</p> <p>1.1. Kada to se zatraži od države prijema;</p> <p>1.2. Kada on ili članovi njegove porodice obavljaju postupke koje su u suprotnosti sa vanjskom politikom i naruši</p>
---	---	---



<p>Republikës së Kosovës;</p> <p>1.3. Për shkelje të rënda të dispozitave të këtij ligji ose të akteve të tjera në fuqi;</p> <p>1.4. Për nevoja pune të Shërbimit të Jashtëm;</p> <p>1.5. Në bazë të kërkesës së vetë diplomatit;</p> <p>1.6. Kur ndahet nga jeta;</p> <p>1.7. Kur mbush moshën për pension;</p> <p>1.8. Kur gjendja e paaftësisë shëndetësore pengon në mënyrë të përhershme përmbushjen e detyrave të tij.</p> <p>2. Pas konsultimit me Presidentin, Ministri i Punëve të Jashtme, për rastet e parashikuara në paragrafët 1.4 dhe 1.5 të këtij neni, urdhëron fillimin e procedurave të mbarimit të detyrës së diplomatit jo më pak se tre muaj nga data e emërimit në një pozicion tjetër në Shërbimin e Jashtëm.</p> <p>3. Si përjashtim prej paragrafit 1, nënparagrafi 1.7, të nenit 44 të këtij ligji, Kreu i misionit diplomatik ose postit konsullor mund të vazhdojë me ushtrimin e funksionit edhe pas mbushjes së moshës për pension, nëse dhe deri sa kjo është me interes për Republikën e Kosovës dhe gjendja shëndetësore e Kreut të misionit diplomatik ose postit konsullor e lejon këtë.</p>	<p>the Republic of Kosovo;</p> <p>1.3. For serious violations of the provisions of this law or other applicable acts;</p> <p>1.4. For the duty needs of the Foreign Service;</p> <p>1.5. Based on the request of the diplomat itself;</p> <p>1.6. When dies;</p> <p>1.7. When reaches retirement age;</p> <p>1.8. When the state of the health disability, permanently prevents the fulfillment of his duties.</p> <p>2. After the consultation with the President, Minister of Foreign Affairs, for the cases stipulated in paragraph 1.4 and 1.5 of this Article, orders initiation of procedures of termination of duties of the diplomat not less than three months from the date of appointment to another position in the Foreign Service.</p> <p>3. As an exception from paragraph 1, subparagraph 1.7, of Article 44 of this law, the head of diplomatic mission or consular post may continue to exercise the function even after the age of retirement, if and until it is of interest to the Republic of Kosovo and the state of health of the head of diplomatic mission or consular post permits this.</p>	<p>imidž Republike Kosovo;</p> <p>1.3. Za teška kršenja odredbi ovog zakona ili drugim važećim aktima;</p> <p>1.4. Za potrebe rada Inostranih Službi;</p> <p>1.5. U skladu sa zahtjevom diplomata;</p> <p>1.6. Kada umre;</p> <p>1.7. Kada dostigne starost za penziju;</p> <p>1.8. Kada se zdravstveno stanje sprečava ispunjenje svojih dužnosti.</p> <p>2. Ministar Inostranih Poslova, u slučajevima predviđenim u stavovima 1.4 i 1.5 ovog članka, da nalog za pokretanje procedure za završetak diplomatske dužnosti ne manje od tri meseca od dana imenovanja na drugu poziciju u Inostranoj Službi.</p> <p>3. Kao izuzet od stava 1, tačka 1.7 člana 44 ovog zakona, šef diplomatske ili konzularnog misije može nastaviti da vrši funkciju nakon odlazka u penziju, osim ako je sve to od interesa za Republika Kosovo i zdravstveno stanje šefa diplomatske misije ili konzularnog predstavništva dozvolava to.</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 45</b> <b>Pezullimi i Kreut dhe personelit të misionit diplomatik dhe postit konsullor</b></p> <p>1. Kreu dhe personeli i misionit diplomatik dhe postit konsullor mund të pezullohen nga detyra në rastet e përcaktuara me akt nënligjor si dhe në rastin kur ndaj tij fillon procedura penale, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.</p> <p>2. Në rastin kur procedura penale pushohet ose kur me vendim gjyqësor të formës së prerë personi deklarohet i pafajshëm, nëpunësi rikthehet në Shërbimin e Jashtëm dhe njëkohësisht rifiton statusin, pagën dhe çdo të drejtë tjetër të ndërprerë që nga çasti i pezullimit.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 45</b> <b>Suspension of the head and the personnel of diplomatic mission and consular post</b></p> <p>1. The head and the personnel of diplomatic mission and consular post may be suspended from duty in cases determined by the sublaw act as well as when the criminal proceedings are initiated against him, until the final decision has been taken.</p> <p>2. In case, where criminal proceedings are ceased or when through the final decision of court the person is declared innocent, the employee returns to the Foreign Service and at the same time regains the status, salary and any other terminated right from the moment of suspension.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 45</b> <b>Suspendiranje šefa i osoblja diplomatskih i konzularnih misija</b></p> <p>1. Šef i osoblja diplomatskih i konzularnih misija može biti privremeno udaljeni od dužnosti u slučajevima utvrđenim podzakonskim aktom, kao i kad se krivično postupa protiv njega, sve do donošenja konačne odluke.</p> <p>2. Kada se krivični postupak prekine ili kada je oslobođen sudske odluke konačno, službenik se vrati u Inostranoj Službi, kao i povrati status, platu i svako drugo pravo koje se obustavlja od trenutka suspenzije.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 46</b> <b>Përgjegjësia disiplinore</b></p> <p>1. Diplomati i karrierës, si dhe çdo nëpunës tjetër i Shërbimit të Jashtëm, përgjigjet për shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të funksionit dhe realizimit të detyrave të ngarkuara në përputhje me rregullat e përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet nënligjore.</p> <p>2. Përgjegjësia disiplinore e Kreut të misionit diplomatik ose postit konsullor dhe e diplomatëve të tjerë të karrierës për caktohet</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 46</b> <b>Disciplinary responsibility</b></p> <p>1. Career diplomat, as well as any other employee of the Foreign Service is responsible for violations committed while exercising functions and performing assigned duties in accordance with the regulations determined by this law and sublaw acts.</p> <p>2. Disciplinary responsibility of the head of the diplomatic mission and consular post and other career diplomats is determined by the</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 46</b> <b>Disciplinska odgovornost</b></p> <p>1. Diplomata u karijeri, kao i bilo koji drugi službenik Inostrane Službe, odgovoran je za počinjene kršenje tokom performanse i dužnosti u skladu s pravilima utvrđenim ovim zakonom i podzakonskim aktom.</p> <p>2. Disciplinska odgovornost šefa diplomatske ili konzularne misije i druge diplomate od karijere odredi Komisija za Diplomatsku</p>

<p>nga Komisioni i Karrierës Diplomatike, i cili i propozon ministrit të Punëve të Jashtme dhënien e masës disiplinore. Në rastet kur masa disiplinore është shkarkimi i një Kreu të misionit diplomatik ose postit konsullor, Ministri për Punë të Jashtme shqipton masën disiplinore në fjalë vetëm pas konsultimit me Presidentin.</p> <p>3. Procedurat e dhënies së masës disiplinore sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 47</b> <b>Humbja e statusit të diplomatit të karrierës</b></p> <p>1. Diplomati i karrierës e humb statusin e diplomatit të karrierës kur:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Ndahet nga jeta;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Largohet në mënyrë vullnetare nga Shërbimi i Jashtëm;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3. Plotëson moshën për pension;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.4. Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një ose më shumë veprave penale;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.5. Heq dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Si përjashtim prej paragrafit 1, nënparagrafi 1.3, të nenit 47 të këtij ligji, diplomati i karrierës mund të vazhdojë punën në</p>	<p>Diplomatic Career Commission which proposes to the Minister of Foreign Affairs disciplinary measures. In cases where disciplinary measure is dismissal of a head of mission or consular post, the Minister of Foreign Affairs imposes the said disciplinary measure only after consultation with the President.</p> <p>3. Procedures of imposing disciplinary measure in accordance with paragraph 2 of this Article are determined by the sublaw act.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 47</b> <b>Loss of career diplomat status</b></p> <p>1. Career diplomat loses the status of career diplomat when:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Dies;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Retires voluntarily from the Foreign Service;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3. Meets the retirement age;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.4. Sentenced through the final court decision for committing one or more offenses;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.5. Resigns from the citizenship of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. As an exception from paragraph 1, subparagraph 1.3 of Article 47 of this law, career diplomat may continue working in the Foreign</p>	<p>Karijeru koju predlaže Ministar Inostranoh Poslova za sprovođenje disciplinske mere. U slučajevima kada disciplinski postupak je uklanjanje šefa diplomatske ili konzularne misije, Ministar Inostranih Poslova određuje disciplinsku meru u pitanju tek nakon konsultacije sa Predsednikom.</p> <p>3. Postupci za dodjelu disciplinske mere iz stava 2 ovog člana utvrđuje se podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 47</b> <b>Gubitak statusa diplomata od karijere</b></p> <p>1. Diplomata u karijeri gubi status karijere diplomata kada je:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Umre;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.2. Ode dobrovoljno iz službe Inostranih Poslova;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.3. Dostigne starost za penziju;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.4. Osuđen pravomoćnom sudskom odlukom, koju je počinio jednu ili više krivičnih dela;</p> <p style="padding-left: 20px;">1.5. Odriče se od državljanstva Republike Kosovo.</p> <p>2. Izuzetno od stava 1, tačka 1.3 člana 47.ovog zakona, diplomata od karijere mogu nastaviti rad u Inostranoj Službi sa odlukom</p>
--	--	---

<p>Shërbimin e Jashtëm me vendim të Ministrit për Punë të Jashtme edhe pas mbushjes së moshës për pension, nëse dhe deri sa kjo është me interes për Republikën e Kosovës dhe gjendja shëndetësore e diplomatit të karrierës e lejon këtë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 48</b> <b>Dhënia e gradave</b></p> <p>1. Diplomatët e karrierës i marrin gradat diplomatike njëra pas tjetrës. Kriteret për dhënien e një grade diplomatike janë:</p> <p>1.1. Periudha minimale e shërbimit nga njëra gradë në tjetrën;</p> <p>1.2. Vlerësimi i punës;</p> <p>1.3. Kualifikimet profesionale brenda ose jashtë vendit;</p> <p>1.4. Kalimi me sukses i testimit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, dhe një përgatitje graduale profesionale të ndërtuar nga Akademia Diplomatike;</p> <p>1.5. Nevojat e Shërbimit të Jashtëm.</p> <p>2. Grada “Atashe” përfitohet me konfirmimin e statusit të diplomatit të karrierës.</p> <p>3. Gradat nga “Sekretar i Tretë” deri</p>	<p>Service by the decision of the Minister of Foreign Affairs even after he reaches the age of retirement, if and until it is of interest to the Republic of Kosovo and the state of health of the head of diplomatic mission or consular post permits this.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 48</b> <b>Rank awards</b></p> <p>1. Career diplomats obtain diplomatic ranks one after the other. Criteria for the award of a diplomatic rank are:</p> <p>1.1. The minimum period of service from one to another rank;</p> <p>1.2. Work evaluation;</p> <p>1.3. Professional qualifications inside the country or abroad;</p> <p>1.4. The successful passing of the test, as foreseen in paragraph 4 of this Article, and a gradual professional training built by the Diplomatic Academy;</p> <p>1.5. The needs of Foreign Service.</p> <p>2. “Attaché” rank is obtained by the confirmation of the status of career diplomat.</p> <p>3. The ranks from the “Third Secretary” to “Plenipotentiary Minister” are awarded by the</p>	<p>Ministra Inostranih Poslova nakon odlazaka u penziju, osim ako i sve dok je od interesa za Republiku Kosovo i zdravstveno stanje diplomate dozvoljava.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 48</b> <b>Davanje Činova</b></p> <p>1. Diplomate karijere dobiće diplomatske činove jedno za drugim. Kriteriji za dodjelu diplomatskih činova su:</p> <p>1.1. Minimalni rok službe iz jednog čina u drugi ;</p> <p>1.2. Evaluacija rada;</p> <p>1.3. Profesionalne kvalifikacije unutar ili van zemlje;</p> <p>1.4. Prolazak uspešno test predviđen u stavu 4. ovog člana, i gradualno profesionalno pripremanje građeno od Diplomatske Akademije;</p> <p>1.5. Potrebe Inostranih Službi.</p> <p>2. Pozicija "Ataše" dobija se sa potvrdom o statusu diplomata.</p> <p>3. Činovi od "Trećeg Sekretara" do "Punomoćeni Ministar" daju se od Komisije</p>
--	--	--

<p>“Ministër Fuqplotë” jepen nga Komisioni i Karrierës Diplomatikesipas procedurës së përcaktuar me akt nënligjor.</p> <p>4. Gradat diplomatike “Këshilltar”, “Ministër Këshilltar”, “Ministër Fuqplotë” dhe “Ambasador” përfitohen pas kalimit me sukses të provimit të organizuar nga Komisioni i Karrierës Diplomatike në bashkëpunim me Akademinë Diplomatike. Përmbajtja dhe mënyra e kryerjes së këtij provimi përcaktohet me akt nënligjor.</p> <p>5. Për përfitimin e gradave “Ministër Këshilltar” dhe “Ministër Fuqplotë”, përveç kushteve tjera të përcaktuara në këtë nen, kandidati duhet të ketë të paktën dy vjet përvojë në poste drejtuese ose të ketë shërbyer në misionet diplomatike ose postet konsullore për të paktën dy vjet.</p> <p>6. Diplomatët e karrierës e përfitojnë gradën “Ambasador” pasi të kenë fituar njëra pas tjetrës të gjitha gradat diplomatike sipas këtij ligji dhe të kenë shërbyer në dy misione diplomatike ose poste konsullore të ndryshme.</p> <p>7. Ministri i Punëve të Jashtme, bazuar në rekomandimin e Komisionit të Karrierës Diplomatike, i jep gradën “Ambasador” diplomatit të karrierës që përmbush kriteret e parashikuara në paragrafin 6.</p> <p>8. Numri maksimal i ambasadorëve, ministrave fuqplotë dhe ministrave këshilltarë përcaktohet me vendim të Ministrit të Punëve</p>	<p>Diplomatic Career Commission according to the procedure determined by the sublaw act.</p> <p>4. The diplomatic ranks “Counselor”, “Minister Counselor”, “Plenipotentiary Minister” and “Ambassador” are obtained after successfully passing the examination organized by the Diplomatic Career Commission in cooperation with the Diplomatic Academy. The content and the method of performing this examination are determined by the sublaw act.</p> <p>5. To obtain the ranks “Minister Counselor” and “Plenipotentiary Minister”, in addition to other conditions determined in this Article, the candidate must have at least two years of experience in management positions or have served in diplomatic missions or consular posts for at least two years.</p> <p>6. Career diplomats obtain the rank “Ambassador” after having obtained one after another all diplomatic ranks according to this law and have served in two different diplomatic missions or consular posts.</p> <p>7. Minister of Foreign Affairs, based on the recommendation of the Diplomatic Career Commission awards the rank “Ambassador” to the career diplomat who meets the criteria determined in paragraph 6.</p> <p>8. The maximum number of ambassadors, plenipotentiary ministers and minister counselors are determined by the decision of</p>	<p>Diplomatske Karijere prema postupku propisanom po propisima.</p> <p>4. Diplomatskih Činovi "Savjetnik", "Ministar Savjetnik", "Punomoći Ministar" i "Ambasador" dobija se nakon uspješno položenog ispita u organiziran od Diplomatske Komisije u Karijeri u saradnji sa Diplomatskom Akademijom. Sadržaj i način obavljanja ovog testa se određuje podzakonskim aktom.</p> <p>5. Za dobijanje činova "Ministar Savjetnik" i "Punomoćeni Ministar", pored ostalih određenih uslova u ovom poglavlju, kandidat mora imati najmanje dvije godine radnog iskustva na rukovodećim pozicijama ili su služili u diplomatskim misijama ili konzularnim najmanje dvije godine.</p> <p>6. Diplomate u Karijeri dobija čin "Ambasador", nakon što je osvojio jedan za drugim sve diplomatske redove u skladu sa ovim zakonom i da je odslužio dvije diplomatske misije ili druge konzularne.</p> <p>7. Ministar Inostranih Poslova, na osnovu preporuka Komisije za Diplomatsku Karijeru daje čin "Ambasador" za diplomate koji su ispunili predviđene kriterije iz stava 6.</p> <p>8. Maksimalan broj ambasadora, ministara punomoćnih i ministri savjetnici odredi Ministar Inostranih Poslova.</p>
---	---	--

<p>të Jashtme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 49</b> <b>Afatet për marrjen e gradave diplomatike</b></p> <p>1. Periudha minimale për kalimin e diplomatit nga një gradë në një tjetër më të lartë është:</p> <p>1.1. 2 (dy) vjet nga Atashe në Sekretar i Tretë.</p> <p>1.2. 2 (dy) vjet nga Sekretar i Tretë në Sekretar i Dytë.</p> <p>1.3. 2 (dy) vjet nga Sekretar i Dytë në Sekretar i Parë.</p> <p>1.4. 3 (tre) vjet nga Sekretar i Parë në Këshilltar.</p> <p>1.5. 3 (tre) vjet nga Këshilltar në Ministër Këshilltar.</p> <p>1.6. 3 (tre) vjet nga Ministër Këshilltar në Ministër Fuqplotë.</p>	<p>the Minister of Foreign Affairs.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 49</b> <b>Deadlines for obtaining diplomatic ranks</b></p> <p>1. The minimum period for a diplomat to pass from one rank to the higher one is:</p> <p>1.1. 2 (two) years from Attaché to Third Secretary.</p> <p>1.2. 2 (two) years from Third Secretary to Second Secretary.</p> <p>1.3. 2 (two) years from Second Secretary to First Secretary.</p> <p>1.4. 3 (three) years from First Secretary to Counselor.</p> <p>1.5. 3 (three) years from Counselor to Minister Counselor.</p> <p>1.6. 3 (three) years from Minister Counselor to Plenipotentiary Minister.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 49</b> <b>Rok za dostizanje diplomatske činove</b></p> <p>1. Minimalni period da prođe kroz diplomatske činove od prvog stepena u najvišem stepenu je:</p> <p>1.1. 2 (dve) godine od Ataše u Treći Sekretar.</p> <p>1.2. 2 (dve) godine od trećeg Sekretara u Drugi Sekretar.</p> <p>1.3. 2 (dve) godine od Drugog Sekretara u Prvi Sekretar.</p> <p>1.4. 3 (tri) godine od Prvog Sekretara u Savjetnika.</p> <p>1.5. 3 (tri) godine od Savetnika u Ministar savjetnik.</p> <p>1.6. 3 (tri) godine od Ministar Savjetnik u Punomoćeni Ministar.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 50</b> <b>Barasvlera e gradave diplomatike dhe konsullore</b></p> <p>1. Në poste dhe detyra konsullore, diplomatët emërohen me grada konsullore. Kalimi nga grada diplomatike në atë konsullore bëhet duke</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 50</b> <b>Equivalence of diplomatic and consular ranks</b></p> <p>1. At the posts and consular duties, the diplomats are appointed by the consular ranks. Passing from diplomatic to consular rank is</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 50</b> <b>Ekvivalencije diplomatskih činova</b></p> <p>1. Pozicije i konzularnih dužnosti, diplomati imenuju se sa konzularnim činovima. Prolazak u diplomatski rang u konzularnim je poštujući</p>

<p>respektuar barasvlerën e gradave, si vijon:</p> <p>1.1. Konsull i Përgjithshëm është i barasvlershëm me Ministër Këshilltar ose Këshilltar;</p> <p>1.2. Konsull është i barasvlershëm me Sekretar i Parë ose i Dytë;</p> <p>1.3. Zëvendës Konsull është i barasvlershëm me Sekretar i Dytë ose i Tretë;</p> <p>1.4. Agjent konsullor është barasvlershëm me Sekretar i Tretë ose Atashe.</p>	<p>done by respecting the equivalence of ranks, as follows:</p> <p>1.1. Consul General is equivalent to Minister Counselor or Counselor;</p> <p>1.2. Consul is equivalent to First or Second Secretary;</p> <p>1.3. Vice Consul is equivalent to Second or Third Secretary;</p> <p>1.4. Consular Agent is equivalent to Third Secretary or Attaché.</p>	<p>ekvivalencije činova, kako slijedi:</p> <p>1.1. Generalni konzul je ekvivalent sa Ministar Savetnik ili Savetnik;</p> <p>1.2. Konzul je ekvivalent Prvim Sekretarom ili Drugi;</p> <p>1.3. Zamenik-konzul je ekvivalent sa Drugim Sekretarom ili treći;</p> <p>1.4. Konzularna Agent je ekvivalent sa Trećim Sekretarom ili Ataše.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 51</b> <b>Të drejtat e diplomatit të karrierës</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 51</b> <b>The rights of the career diplomat</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 51</b> <b>Prava diplomate u karijeru</b></p>
<p>1. Diplomati i karrierës ka të drejtë:</p> <p>1.1. Të gëzojë statusin e diplomatit të karrierës;</p> <p>1.2. Të përfitojë gradë diplomatike personale;</p> <p>1.3. Të mbajë funksione në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në misionet diplomatike ose postet konsullore, në përputhje me gradën diplomatike, aftësitë dhe eksperiencën profesionale;</p> <p>1.4. Të përfitojë nga imunitetet dhe lehtësitë që i jep statusi i diplomatit në</p>	<p>1. Career diplomat has the right to:</p> <p>1.1. Enjoy the status of the career diplomat;</p> <p>1.2. Obtain personal diplomatic rank;</p> <p>1.3. Hold functions in the Ministry of Foreign Affairs, in diplomatic missions or consular posts, in accordance with diplomatic rank, skills and professional experience;</p> <p>1.4. Benefit from immunities and facilities that the diplomatic status is</p>	<p>1. Diplomata u karijeri imaju pravo:</p> <p>1.1. Uživaju status diplomata karijere.</p> <p>1.2. Da dobijaju činove diplomatskog ranga.</p> <p>1.3. Da održe funkcije u Ministarstvu Inostranih Poslova, diplomatske ili konzularne misije, u skladu s diplomatskim činom, veštine i profesionalno iskustvo.</p> <p>1.4. Da koristi od imuniteta i olakšice koje daje diplomatski status u skladu sa</p>

<p>përputhje me aktet dhe të drejtën ndërkombëtare, gjatë periudhës kur është i emëruar në misionin diplomatik ose postin konsullor;</p> <p>1.5. Të përfitojë nga kualifikimet dhe trajnimet e kryera nga Ministria e Punëve të Jashtme;</p> <p>1.6. Të përfitojë trajtim financiar të posaçëm, në përputhje me statusin e tij dhe sipas këtij ligji;</p> <p>1.7. Të mbajë dhe të përdorë pasaportë diplomatike gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare. Kushtet për dhënien dhe shfrytëzimin e pasaportës diplomatike përcaktohet me akt nënligjor.</p>	<p>giving, in accordance to the acts and international law, during the period when is appointed to a diplomatic mission or consular post;</p> <p>1.5. Benefit from qualifications and trainings conducted by the Ministry of Foreign Affairs;</p> <p>1.6. Benefit special financial treatment in accordance with his status and in accordance to this law;</p> <p>1.7. Possess and use diplomatic passport while exercising official functions. The conditions for obtaining and using diplomatic passport are determined by the sublaw acts.</p>	<p>zakonima i međunarodnog prava, u vrijeme kada je imenovan na diplomatskoj misiji ili konzularnom post.</p> <p>1.5. Da koristi od kvalifikacija i obuke koje provodi Ministarstvo Inostranih Poslova.</p> <p>1.6. Finansijski korist poseban tretman, u skladu sa svojim statusom u skladu sa ovim zakonom.</p> <p>1.7. Održava i koristi diplomatski pasoš u vršenju službene dužnosti. Uslovi za izdavanje i korištenje diplomatski pasoš utvrđuje podzakonskim aktom.</p>
